

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR
PUNIME XHAMI

Kodi: PK-B-9-22

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2022

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME XHAMI”

(PK-B-9-22)

I. Profili profesional i xhamaxhiut

a) Karakteristikat e xhamaxhiut

Xhamaxhiu është i aftë të kryejë **detyra** profesionale, si i punësuar në objekte ndërtimi, apo në ndërmarrje të ndryshme të punimeve të xhamit. Ai/ajo mund të vetëpunësohet, ose mund të hap një biznes të vogël për punime xhami dhe punëson të tjerë në të.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, xhamaxhiu duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale si dhe **shprehi** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të punimeve të xhamit.

Veprimtaria e xhamaxhiut është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

Xhamaxhiu koordinon punën me grupet e tjera të tjera dhe me kolegë duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët.

Ai zbaton rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së shëndetit në punë, të ruajtjes së mjedisit dhe përmbush standardet e sigurimit të cilësisë për shërbimet e kryera.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale.

Xhamaxhiu merret me matjen, prerjen, shpimin, zmusimin, bombardimin, ngjitjen, dhënien formë të xhamit. Kryen montime dhe riparime të xhamave në vetrata, në ndërtesa, në objekte të ndryshme industriale, social - kulturore etj. Ai përdor makineri dhe pajisjet e duhura për procese të ndryshme pune të përpunimit të xhamit. Xhamaxhiu mund të punësohet në kompani të shërbimeve të ndryshme në ndërtim, në konstruksione metalike, në subjekte të përpunimit të drurit apo të vetëpunësohet.

Profesioni i xhamaxhiut është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kryerjen e punimeve me xham. Ai mund të punësohet në firma ndërtimi, ose vetpunësohet në ndërmarrje/ biznese që kryejnë veprimtari në sektorin e punimeve të xhamit.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e punëtorit të kualifikuar të punimeve xhamit. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një punëtor për punime xhami mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e këtij profesioni në nivelin e inxhinierit.

Për të zhvilluar aktivitet privat në fushën e punimit të xhamit, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në grupin-njësi “Xhamaxhinj”, me kod 7125 referuar Listës Kombëtare të Profesioneve

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Punime xhami”

Në përfundim të kursit për “Punime xhami”, kursantët do të jenë të aftë të:

- përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik për punime xhami
- realizojnë organizimin e vendit të punës për punim xhami
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit të punës gjatë punimeve të xhamit
- kryejnë procese parapërgatitore për punim xhami
- përzgjedhin drejt dhe përdorin në mënyre korrekte veglat, pajisjet dhe instrumentat e punës për punim xhami
- përzgjedhin materialet dhe aksesoret e duhura për punimet e xhamit
- interpretojnë vizatime teknike dhe përgatisin skica të thjeshta për punime xhami
- realizojnë prerje xhami, shpim, zmusim, bombardim me vegla dhe makineri
- kryejnë mbulimin e strehës me xham
- kryejnë mbulimin e pjesshëm të soletës/ çatisë me xham
- kryejnë punimet e dyshemesë prej xhami
- kryejnë punime xhami në dyer e dritare, elementet e shkallëve, në fasada, në sipërfaqet e reklamave të ndryshme
- realizojnë produkte të gatshme prej xhami.
- kryejnë montime të pjesëve të produkteve të gatshme
- mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës.
- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për punimet e xhami.
- zbatojnë standardet e profesionit.
- komunikojnë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Punime xhami”

Pjesëmarrësit në Kursin “Punime xhami” duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Punime xhami”

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Punime xhami”

Nr	Titulli i Modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e xhamaxhiut	MK-02-350-22	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të xhamaxhiut. 2. Kursanti përshkruan aksesoret dhe materialet ndihmëse në punime xhami. 3. Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet dhe instrumentet në punime xhami. 4. Kursanti përshkruan llojet e xhamave. 5. Kursanti interpreton dhe përgatit dokumentacionin teknik për punime xhami. 6. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në punime xhami.

2	Proceset bazë në punime xhami	MK-02-351-22	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti pret xhamin me vegla dhe pajisje dore. 2. Kursanti shpon xhamin me vegla dore elektrike. 3. Kursanti zmuson xhamin me vegla dore dhe makineri. 4. Kursanti bombardon xhamin me vegla dore dhe makineri.
3	Punime xhami për mbulime	MK-02-352-22	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen procese parapërgatitore për punime xhami në mbulesat. 2. Kursanti kryen mbulimin e strehës me xham. 3. Kursanti kryen mbulimin e pjesshëm të soletës/çatisë me xham.
4	Punime xhami për rifiniturë.	MK-02-353-22	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen veprime parapërgatitore në sipërfaqet e rifiniturës për punime xhami. 2. Kursanti kryen punimet e dyshemesë prej xhami. 3. Kursanti kryen punime xhami në dyer e dritare 4. Kursanti kryen punime xhami në elementet e shkallëve.
5	Punime xhami për fasada e produkte të gatshme.	MK-02-354-22	100 orë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit punimet e xhamit në fasada e produkte të gatshme. 2. Kursanti kryen kryen punime xhami në sipërfaqet e reklamave. 3. Kursanti kryen punime xhami në fasada. 4. Kursanti realizon produkte të thjeshta prej xhami.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Punime xhami”.

1. Moduli “Hyrje në profesionin e xhamaxhiut”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E XHAMAXHIUT	MK-02-350-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veprimtarinë e xhamaxhiut, me mjedisin, prodhimet, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së xhamaxhiut, me aksesoret, materialet ndihmëse në punime xhami veçoritë dhe llojet e xhamave.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të xhamaxhiut. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë legjislacionin në fuqi dhe kodin e punës. - të përshkruajë kërkesat profesionale të xhamaxhiut. - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të xhamaxhiut. - të tregojë mundësitë e punësimit të xhamaxhiut. - të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të xhamaxhiut. - të përshkruajë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët. - të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës në punime xhami. - të përshkruajë rëndësinë e organizmit të punës, strukturën organizative dhe komunikimin hierarkik. - të përshkruajë mënyrën e llogaritjeve të thjeshta të punimeve të xhamit (kostot dhe volumi i punës, sasia e materialeve, veglave dhe pajisjeve të punës, çmimi i punimeve etj.). Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim. RN 2 Kursanti përshkruan aksesoret dhe materialet ndihmëse në punime xhami. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të listojë aksesore të ndryshme në punime xhami. - të përshkruajë përdorimin dhe funksionalitetin e aksesoreve për punime xhami. - të listojë materialet ndihmëse në punime xhami.	

- të përshkruajë mënyrat e përdorimit të materialeve ndihmëse në punime xhami.
- të interpretojë përbërjen e materialeve ndihmëse sipas përdorimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet dhe instrumentet në punime xhami.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë mjedisin në funksionet përkatëse për punime xhami.
- të përshkruajë klasifikimin e veglave, pajisjeve, makinerive dhe instrumentave në punime xhami.
- të listojë veglat, pajisjet, dhe instrumentat për prerjen e xhamit, përdorimet e tyre.
- të listojë veglat, pajisjet, dhe instrumentat për shpimin në punimet e xhamit, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të listojë veglat, pajisjet, dhe instrumentat për zmusimin e xhamit, përdorimet e tyre.
- të listojë veglat dhe pajisjet për bombardimin e xhamit, përdorimet e tyre.
- të listojë veglat dhe pajisjet dhe makineritë për montimet e elementeve prej xhami, përdorimet e tyre.
- të përshkruajë rregullat e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve, makinerive dhe instrumentave për punime xhami.
- të listojë veglat dhe pajisjet për punime xhami në objekte të gatshme me materiale të tjera.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Kursanti përshkruan llojet e xhamave.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë mënyrat e prodhimit të llojeve të ndryshme të xhamave.
- të listojë xhamat sipas funksionalitetit dhe përbërjes.
- të përshkruajë klasifikimin dhe përdorimet përkatëse të xhamave.
- të përshkruajë llojet, karakteristikat, markat dhe përdorimet e xhamit.
- të përshkruajë mënyrat e përpunimit të xhamave
- të shpjegojë mënyrat e rëndësishme të ambalazhimit, transportimit e magazinimit të xhamave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Kursanti interpreton dhe përgatit dokumentacionin teknik për punime xhami.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të dallojë standardet, simbolet shenjat në vizatimin teknik.
- të zbatojë standardet bazë në vizatim teknik.
- të interpretojë vizatime/detaje me punime të ndryshme me material xhami.
- të skicojë punime të ndryshme me material xhami sipas projektit.
- të interpretojë shënimet teknike për punime xhami në fletët e projektit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RN 6 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në punime xhami

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve me xham.
- të përshkruajë burimet e rreziqeve në objekte;
- të përshkruajë procedurat dhe protokollet standarde të sigurisë sipas rastit të emergjencës (zjarr, tërmet, përmytje, etj.);
- të përshkruajë masat e mbrojtjes së mjedisit ku kryhen punimet xhami.
- të përdorë kompletin e veshjes së punës dhe rripin e sigurimit në punime në lartësi.
- të përdorë mjetet/tabelat sinjalizuese të sigurimit teknik.
- të shpjegojë rëndësinë dhe përmbajtjen e kutisë së ndihmës së shpejtë.
- të përshkruajë masat për largimin e mbeturinave në vendin e duhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me shkrim dhe gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punimeve të xhamit. Rekomandohen dhe vizita dhe praktika në reparte punimesh xhami të bizneseve lokale. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet dhe demonstrimet konkrete për kushtet, mjediset, pajisjet, veglat dhe materialet e punës në repartin e punimeve të xhamit, për matjet dhe kontrollet, për vizatimet dhe skicat e punimeve të xhamit, si dhe për masat e sigurisë dhe dhënien e ndihmës së parë. - Kursantët duhet të demonstrojnë kryerjen e matjeve, shënimeve dhe kontrolleve, interpretimin e vizatimeve, bërjen e skicave, marrjen e masave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mejdisit dhe dhënien e ndihmës së parë për të dëmtuarit, si dhe të angazhohen në diskutime në lidhje me mjedisin, kushtet dhe kërkesat gjatë realizimit të punimeve të xhamit. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet tu kërkohet atyre që të përshkruajnë konkretisht mjedisin, pajisjet, veglat, materialet, kushtet e kërkesat e profesionit të punuesit të xhamit, si dhe të demonstrojnë, matjet e kontrollet, bërjen e skicave, marrjen e masave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit dhe dhënien e ndihmës së parë për të dëmtuarit. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedis i punimeve të xhamit, tavolina pune. - Komploti i veglave, makinerive për punime xhami. - Instrumente shënues, matëse dhe kontrolluese. - Makinat dhe instrumentet e punës për prerje,ngjyrosje,bombardim,luçidim,zmusim,shpim,etj. - Aksesorët dhe materialet ndihmëse për punime xhami. - Kutia e ndihmës së shpejtë,tabela sigurimit teknik, rripi sigurimit, komploti i veshjes punës. - Vizatime dhe skica pune të prodhimeve duralumini. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. - Media didaktike (CD, filmime, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.

2. Moduli “Proceset bazë në punime xhami”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PROCESET BAZË NË PUNIME XHAMI	MK-02-351-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me llojet dhe veçoritë e proceseve bazë në punime xhami, si dhe i aftëson ata për të kryer këto procese pune me vegla dore, dhe makineri.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përmbushur modulën “Hyrje në profesionin e xhamaxhiut”.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti pret xhamin me vegla dhe pajisje dore. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të analizojë skicën ose vizatimin/detajin e punimeve të xhamit . - të përzgjedhë llojin e xhamit për prerje. - të përshkruajë llojet e pajisjeve, vegla dore dhe përdorimet e tyre në punimet e prerjes së xhamit. - të realizojë matje dhe shënime të sakta në sipërfaqet e xhamit. - të zbatojë teknikat e duhura të prerjes së xhamave me vegla dhe pajisje dore. - të tregojë kujdesin e duhur gjatë prerjes së xhamave njëra me tjetrën. - të zbatojë teknikat e duhura të gdhëndjes së mureve me daltë, për montime të prodhimeve të duraluminit në objekt. - të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti shpon xhamin me vegla dore elektrike. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të analizojë skicën ose vizatimin/detajin e punimeve të xhamit për shpim. - të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera. - të përzgjedhë llojin e xhamave për shpim. - të përshkruajë llojet shpimeve me vegla dore elektrike në sipërfaqet e xhamit. - të realizojë matje dhe shënime të sakta në sipërfaqet e xhamit sipas skicës. - të zbatojë teknikat e duhura për shpim xhami me vegla dore elektrike.	

- të tregojë kujdesin e duhur gjatë shpimit të xhamave
- të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti zmuson xhamin me vegla dore dhe makineri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera.
- të tregojë vendet e duhura për zmusim xhami me vegla dore dhe makineri.
- të tregojë domosdoshmërinë dhe mënyrat e zmusimit të xhamit me vegla dore dhe makineri.
- të tregojë funksionimin e makinerive të zmusimit në sipërfaqen e xhamit.
- të zbatojë teknikat e duhura të zmusimit të xhamit me vegla dore dhe makineri.
- të realizojë procedurat e zmusimit të xhamit me vegla dore dhe makineri.
- të realizojë pastrimin e xhamit mbas zmusimit të tij me vegla dore.
- të realizojë procedurat e luçidimit mbas zmusimit të xhamit me vegla dore dhe makineri.
- të realizojë pastrimin përfundimtar të xhamit mbas realizimit të proceseve.
- të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti realizon bombardon xhamin me vegla dore dhe makineri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë llojet e xhamit për bombardim.
- të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera.
- të përshkruajë llojet e mënyrave të bombardimeve me vegla dore e makineri dhe përdorimet e tyre në punimet e xhamit.
- të përshkruajë përdorimin e veglave të dorës dhe makinerive punimet e bombardimit të xhamave.
- të zbatojë teknikat e duhura në punimet e bombardimit të xhamave me vegla dore e makineri.
- të tregojë kujdes për zbatimin e kohës së duhur në bombardimin e xhamit me vegla dore e makineri.
- të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punimeve të xhami dhe në reparte punimesh xhami të bizneseve. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të proceseve bazë të punimit të xhamit, me vegla dore dhe makineri. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike të prerjes, shpimit, zmusimit, luçidimit, bombardimit, etj., me vegla dore dhe me makineri, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë zbatimit të modulit. - Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë e ruajtjen e mjedisit. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: - Objekt ndërtimi dhe reparte pune me punime xhami. - Komploti i veglave të dorës për punime xhami. - Komploti i makinerive të punimit të xhamit. - Instrumente e makineri për zmusim, luçidim, bombardim - Instrumente matëse dhe kontrolluese. - Materiale e aksesore xhami, pastrues xhami, tavolinë pune . - Katalloge, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. - Medie didaktike (CD, filmime, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.

3. Moduli “Punime xhami për mbulime.”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME XHAMI PËR MBULIME	MK-02-352-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurën e punës për punime xhami për mbulime të ndryshme, si dhe i aftëson ata për të kryer këto punime me vegla dore e makineri.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përmbushur modulën “Hyrtje në profesionin e xhamaxhiut”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti kryen procese parapërgatitore për punime xhami në mbulesa. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë llojet e mbulesave prej xhami, veçoritë arkitektonike dhe përdorimet e tyre. - të përshkruajë materialet dhe aksesorët që përdoren për mbulesa prej xhami. - të përshkruajë procesin teknologjik për ndërtimin e mbulesave prej xhami. - të përshkruajë kushtet dhe kërkesat teknike të realizimit të mbulesave prej xhami. - të kryejë matje dhe shënime paraprake. - të përgatisë preventivin e materialeve dhe aksesorëve të nevojshëm. - të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe makineritë që nevojiten për punime xhami në mbulesa - të realizojë organizimin e vendit të punës sipas procesit. - të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti kryen mbulimin e strehës me xham. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të analizojë skicën ose vizatimin/detajin e punimeve të strehës me xham sipas projektit. - të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera. - të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera. - të realizojë procedurat e përpunimit të strehës me xham sipas kushteve teknike - të realizojë matje dhe shënime tek strehat duke u koordinuar me objektin.	

- të realizojë hapat teknologjike për mbulimin e strehës me xham.
- të realizojë procedurat e realizimit të pjerrësisë së strehës për largimin e ujrave.
- të realizojë procedurat e montimit të gominave me aksesorët e elementeve të strehës.
- të realizojë me material izolimin bashkimin e pjesëve përbërse të strehës prej xhami.
- të realizojë pastrimin e sipërfaqes së strehës prej xhami.
- të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen mbulimin e pjesshëm të soletës/çatisë me xham.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë skicën ose vizatimin/detajin e punimeve të soletës/çatisë me xham sipas projektit.
- të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera.
- të realizojë matje dhe shënime në soletë/çati duke u koordinuar me projektin.
- të realizojë matje dhe shënime në fletë e xhamit për mbulim sipas detajit të dhënë.
- të realizojë procedurat e prerjes së fletëve të xhamit sipas masave të caktuara.
- të realizojë hapat teknologjike për mbulimin e pjesshëm të soletës/ çatisë me xham.
- të realizojë procedurat e realizimit të pjerrësisë së soletës/ çatisë për largimin e ujrave
- të realizojë procedurat e montimit të gominave me aksesorët e elementeve të tjerë soletës/ çatisë .
- të realizojë me material izolimin bashkimin e pjesëve tjera përbërse të soletës/ çatisë prej xhami.
- të realizojë pastrimin e sipërfaqes së soletës/ çatisë prej xhami.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve në mbulesa.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt ndërtimi dhe në repartin e punimeve të xhamit
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të proceseve të punës për parapregatitjen e vendit të punës, në punime për mbulesa xhami, solete e çatie
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike të matjes, shënimit, prerjes me veglave të dore, dhe me makineri të xhamave, kryerjen e punimeve të mbulesave, soletë e çati me

xham fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur.

- Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë zbatimit të modulit.
- Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e mëposhtme:

- Objekt ndërtimi dhe reparte pune për punime xhami.
 - Komploti i veglave të dorës për punime xhami.
 - Komploti i makinerive të punimit të mbulesave të xhamit.
 - Instrumente e mjete për prerje xhami.
 - Aksesore përkatës për mbulime prej xhami.
 - Instrumente shënimi, matëse dhe kontrolluese.
 - Materiale e aksesore xhami, pastrues xhami, tavolinë pune .
 - Katalloge, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filmime, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.
-

4. Moduli “Punime xhami për rifiniturë”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME XHAMI PËR RIFINITURË	MK-02-353-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurën e punës për punime xhami për rifiniturë, si dhe i aftëson ata për të kryer këto punime duke përdorur vegla dore e makineri.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përmbushur modulën “Hyrye në profesionin e xhamaxhiut”.	
Rezultatet e të Nxënërit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti kryen veprime parapërgatitore në sipërfaqet e rifiniturës për punime xhami. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë llojet e punimeve të rifiniturës me materiale xhami dhe përdorimet e tyre. - të përshkruajë materialet dhe aksesoret që përdoren për punime xhami për rifiniturë. - të përshkruajë procesin teknologjik për ndërtimin e dyshemesë prej xhami. - të përshkruajë procesin teknologjik për punime xhami në dyer dritare. - të përshkruajë procesin teknologjik për ndërtimin apo veshjen e shkallëve prej xhami. - të kryejë matje dhe shënime paraprake në pjesët e rifiniturës. - të përgatisë preventivin e materialeve dhe aksesoreve të nevojshëm. - të përzgjedhë veglat, pajisjeve dhe makineritë që nevojiten për punime xhami në rifiniturë - të realizojë organizimin e vendit të punës sipas procesit. - të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti kryen punimet e dyshemesë prej xhami. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të analizojë skicën ose vizatimin/detajin e punimeve me xham të dyshemesë sipas projektit. - të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera. - të realizojë procedurat e përpunimit të dyshemesë para punimeve me xham sipas kushteve teknike. - të realizojë matje dhe shënime në kuotat e dyshemesë.	

- të realizojë hapat teknologjike për punimet e dyshemesë prej xhami.
- të realizojë procedurat e realizimit të bashkimit të nyjes së murit me dyshemenë.
- të realizojë procedurat e montimit të gominave me aksesoret e elementeve të dyshemesë prej xhami.
- të realizojë me material izolimin bashkimin e pjesëve përbërse të dyshemesë prej xhami.
- të realizojë pastrimin e sipërfaqes së dyshemesë prej xhami mbas punimeve përfundimtare.
- të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti kryen punime xhami në dyer e dritare.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera.
- të analizojë skicën ose vizatimin/detajin e punimeve me xham në dyer e dritare sipas projektit.
- të realizojë matje dhe shënime në kuotat dyer dritare duke u bazuar në dyshemenë.
- të realizojë hapat teknologjike për punimet prej xhami në dyer dritare, vetrata etj.
- të realizojë procedurat e realizimit të bashkimit të dy pjesëve xhamit në sipërfaqet e dyer-dritare, vetrata etj.
- të realizojë procedurat e montimit gominave me aksesoret e elementeve të dyerve dritareve, vetratave prej xhami.
- të realizojë me material izolimin bashkimin e pjesëve përbërse të sipërfaqeve të mëdha prej xhami në dyer-dritare, vetrata etj.
- të realizojë pastrimin e sipërfaqes prej xhami mbas punimeve përfundimtare.
- të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti kryen punime xhami në elementet e shkallëve

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera.
- të analizojë skicën ose vizatimin/detajin e punimeve me xham në pjesët e shkallëve sipas projektit.
- të realizojë matje dhe shënime për kuotat bazamakëve duke u bazuar në dyshemenë e katit.
- të realizojë matje dhe shënime për kuotat parmakëve të shkallëve prej xhami sipas fletës projektit/detajit.
- të realizojë hapat teknologjike për punimet prej xhami në

pjesët e shkallëve.

- të realizojë hapat teknologjike për punimet prej xhami në veshjen me xham të shkallëve.
- të realizojë hapat teknologjike për punimet prej xhami në parmakët e shkallëve.
- të realizojë procedurat e realizimit të bashkimit të pjesëve vertikale e horizontale në shkallë.
- të realizojë procedurat e montimit aksesorëve të elementeve të shkallëve prej xhami (parmakë, muri sheshpushimit etj.)
- të realizojë pastrimin e sipërfaqes prej xhami mbas punimeve përfundimtare.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt ndërtimi e repartin e punimit të xhamit.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të proceseve të punës për punime xhami në dysHEME, DYER-Dritare, vetrata, shkallë etj duke përdorur vegla dore dhe makineri.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike të kontrollit, matjes, shënimit, prerjes, ngjitjes, montimit punimit të elementeve të dyer-dritareve, pjesëve të shkallëve në objekt, me përdorimin e veglave të dorës, dhe makinerive, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë zbatimit të modulit.
- Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Komplet i veglave të dorës për punime xhami.
 - Komplet i makinerive e instrumenteve të punimit të xhamit.
 - Aksesorë përkatës për elementet e shkallës, dyer-dritare, dysHEME prej xhami etj.
 - Instrumente shënimi, matëse dhe kontrolluese.
 - Materiale e aksesorë xhami, pastrues xhami, tavolinë pune .
 - Katalloge, manuale, udhëzues, fletë projekti/detaje materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filmime, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.
-

5. Moduli “Punime xhami për fasada e produkte të gatshme”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME XHAMI PËR FASADA E PRODUKTE TË GATSHME	MK-02-353-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurën e punës për punime xhami për fasada e produkte të gatshme, si dhe i aftëson ata për të kryer këto punime duke përdorur vegla dore e makineri.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përbushur modulën “Hyrje në profesionin e xhamaxhiut”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti parapërgatit punimet e xhamit në fasada e produkte të gatshme. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë llojet e punimeve prej xhami në fasada e prodhime të gatshme dhe përdorimet e tyre. - të përshkruajë materialet dhe aksesoret që përdoren për punime xhami në fasada e prodhime të gatshme. - të përshkruajë procesin teknologjik për punime xhami në fasada . - të përshkruajë procesin teknologjik për punime xhami në prodhime të gatshme. - të kryejë matje dhe shënime paraprake në sipërfaqet e fasadës. - të përgatisë preventivin e materialeve dhe aksesoreve të nevojshëm. - të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe makineritë që nevojiten për punime xhami në fasada e prodhime të gatshme - të realizojë organizimin e vendit të punës sipas procesit. - të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Kursanti kryen punime xhami në sipërfaqet e reklamave. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera. - të analizojë skicën ose vizatimin/detajin e punimeve me produkte xhami/pasqyre në reklama sipas projektit. - të realizojë matje dhe shënime në sipërfaqet e bazamenteve të reklamave.	

- të realizojë matje dhe shënime në sipërfaqet e pasqyrave e xhamave.
- të realizojë hapat teknologjike për punime xhami në reklama të ndryshme.
- të realizojë hapat e punës për realizimin e reklamës.
- të realizojë procedurat e realizimit të bashkimit të pjesëve të reklamave me aksesoret në sipërfaqet ku do instalohen.
- të realizojë pastrimin e sipërfaqes prej xhami/pasqyre mbas punimeve përfundimtare.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti kryen punime xhami në fasada.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera.
- të analizojë skicën ose vizatimin/detajin e punimeve me produkte xhami/pasqyre në fasada sipas projektit.
- të realizojë matje dhe shënime në sipërfaqet e fasadave të ndërtesave.
- të realizojë matje dhe shënime në sipërfaqet e xhamave dhe materialet ndihmëse.
- të realizojë hapat teknologjike për punime xhami në fasada të ndryshme.
- të realizojë hapat e punës për realizimin e montimit me makineri të faqeve xhamave/pasqyrave.
- të realizojë procedurat e realizimit të bashkimit të pjesëve të faqeve të xhamave me aksesoret në sipërfaqet e fasadave.
- të realizojë izolimin/mbushjet midis faqeve të xhami/pasqyre.
- të realizojë pastrimin e sipërfaqes prej xhami/pasqyre mbas punimeve përfundimtare.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti realizon produkte të thjeshta prej xhami.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë skicën ose vizatimin/detajin e produktit të gatshëm prej xhami/pasqyre.
- të bashkëpunojë me specialistët e profileve të tjera.
- të realizojë matje dhe shënime në sipërfaqet xhamave për përdorim.

- të realizojë prerje,shpim,gërvishje,zmusim,lyerje,luçidim etj. në pjesët përbërëse të produktit me vegla dore e makineri.
- të realizojë me teknologjinë e duhur harkime xhamash me makineri.
- të realizojë montimin e pjesëve përbërëse të produkteve të thjeshta prej xhami(gabina dushi,pasqyra tualeti,tavolina mesi,oxhakë,abazhure etj.)
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të marrë masa për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në objekt ndërtimi e në repartin e punimit të xhamit.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të proceseve të punës për punime xhami në fasada, reklama, produkte të gatshme prej xhami duke përdorur vegla dore dhe makineri.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike të matjes, shënimit, shpimit, prerjes të elementeve të xhamit, montimit të elementeve për produktet e gatshme prej xhami, me përdorimin e veglave të dorës, dhe makinerive, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë zbatimit të modulit.
- Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë e ruajtjes së mjedisit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Objekt ndërtimi dhe reparte pune për punime xhami.
 - Komploti i veglave të dorës për punime xhami.
 - Komploti i makinerive të punimit të xhamit.
 - Instrumente e mjete për prerje, shpim, lyerje,veshje, harkim, xhami etj.
 - Aksesore përkatës për bashkimin e elementeve të produktit
 - Instrumente shënimi,matëse dhe kontrolluese.
 - Materiale e aksesore xhami,pastrues xhami,tavolinë pune .
 - Katalloge, manuale, udhëzues, fletë projekti/detaje materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filmime, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.